

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ana e ADVICE MARKETING SHPK Beograd me seli në rr. "Treshninog Cveta" nr. 11, banesa nr. 12, Beogradi i Ri, 11070 Beograd, Republika e Serbisë, dorëzuar përmes të autorizuarit Shoqëria e Avokatëve Konstantinoviç dhe Milloshevski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2026, sollli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin ADVICE MARKETING SHPK Beograd me seli në rr. "Treshninog Cveta" nr. 11, banesa nr. 12, Beogradi i Ri, 11070 Beograd, Republika e Serbisë, fiton 100% të aksioneve dhe kontrollin e vetëm mbi Across Media Holding a.s., me seli në rr. Zohova 3, 811 03 Bratislavë – Qyteti i Vjetër, Republika e Sllovakisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 12.01.2026, plotësuar më 14.01.2026, më 05.02.2026 dhe më 13.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e ADVICE MARKETING SHPK Beograd me seli në rr. "Treshninog Cveta" nr. 11, banesa nr. 12, Beogradi i Ri, 11070 Beograd, Republika e Serbisë, përmes të cilit ADVICE MARKETING SHPK Beograd do të fitojë 100% të aksioneve dhe kontrollin e vetëm mbi Across Media Holding a.s., me seli në rr. Zohova 3, 811 03 Bratislavë – Qyteti i Vjetër, Republika e Sllovakisë.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimet dhe shtojcat e tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ADVICE MARKETING SHPK Beograd ofron shërbime strategjike, këshilluese dhe operative të lidhura me komunikimet e marketingut dhe zhvillimin e brendeve dhe zgjidhje të integruara të marketingut, drejtpërdrejt ose përmes kompanive brenda grupit të saj.

Advice Marketing SHPK Beograd nuk ka shoqëri të varura, degë, filiale ose përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk gjeneron qarkullim apo kryen aktivitete të produkteve ose shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

ACROSS MEDIA HOLDING a.s. është një shoqëri aksionare me seli në Bratislavë, Republika e Sllovakisë, e cila vepron si një kompani mëmë holding e një grupi shoqërish aktive kryesisht në fushat e shërbimeve mediatike, reklamimit dhe komunikimeve të marketingut.

Across Media Holding a.s. është aktive kryesisht në fushat e shërbimeve mediatike, reklamimit dhe shërbimeve të agjencive kreative, dhe funksionon si një rrjet rajonal i agjencive mediatike dhe kreative që ofrojnë shërbime të integruara për komunikimet e marketingut, duke përfshirë planifikimin dhe blerjen e mediave, reklamimin, brendimin, zhvillimin kreativ, komunikimet digjitale, marrëdhëniet me publikun dhe shërbimet e ngjashme konsulente.

Përmes kompanive të grupit të saj, Across Media Holding a.s. ofron një gamë të gjerë shërbimesh mediatike, reklamuese dhe të ngjashme për klientët korporativë nga industri të ndryshme, ndër të tjera:

- Shërbime reklamimi dhe marketingu, përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të marketingut dhe komunikimeve të integruara të marketingut;
- Planifikim mediatik, blerje e mediave dhe shërbime konsulence mediatike;
- Shërbime për hulumtimin dhe analizën e tregut;
- Aktivitete ndërmjetësi në fushën e tregtisë, shërbimeve dhe prodhimit;
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese afariste, organizative dhe ekonomike;
- Shërbime kompjuterike të lidhura me përpunimin e të dhënave dhe mbështetjen e TI-së;
- Shërbime administrative dhe mbështetje back office për kompanitë e grupit dhe klientët e jashtëm.

Across Media Holding a.s. ka tre shoqëri të varura të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat janë aktive në ofrimin e shërbimeve të agjencive mediatike, reklamuese dhe shërbimeve të agjencive kreative, si dhe video produksion dhe shërbime të ngjashme mediatike. Këto kompani ofrojnë shërbime për klientët që operojnë në industri të ndryshme në tregun maqedonas, si më poshtë:

-Agjencia për komunikime të marketingut dhe shërbime MEKKEN SHPKNJP Shkup, me seli në bul. 8 Shtatori nr. 16 Shkup, e cila ofron një spektër të plotë të shërbimeve për komunikimet

e marketingut, duke përfshirë strategjinë e komunikimit dhe menaxhimin e komunikimeve, strategjinë kreative dhe zgjidhjet kreative, shërbimet e brendimit, marrëdhëniet me publikun, komunikimet digjitale, promovimet dhe ngjarjet, aktivitetet e lidhura me sponsorizimet, si dhe shërbime të tjera të integruara për komunikimet e marketingut;

-Agjencia për komunikime të marketingut dhe shërbime AD+VENTURE SHPKNJP Shkup me seli në bul. Arradhat Partizane nr. 26A-1/2 Shkup, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh për përmbajtje dhe produksion që mbështesin aktivitetet kreative dhe reklamuese, duke përfshirë video produksionin, grafikën e lëvizshme dhe animacionet (2D dhe 3D), efektet vizuale (VFX) dhe vizualizimet 3D; dhe

-Shoqëria për komunikime të marketingut dhe shërbime UNIVERSAL MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në bul. 8 Shtatori nr. 16 Shkup, e cila është aktive në fushën e agjencive mediatike, duke përfshirë planifikimin mediatik, blerjen e mediave dhe konsulencën mediatike. Shoqëria funksionon si një agjenci kreative mediatike e fokusuar në kombinimin e njohurive të bazuara në të dhëna dhe qasjeve kreative me qëllim arritjen e rezultateve efektive të komunikimit për klientët e saj.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ